

Inagurimi i nisjes se punimeve per Velipoja "Grand Europa" Resort, investim i kompanise Xhenis SH.P.K, eshte kulmuar mbremjen e se premtes me nje koncert madheshtor ne qender te plazhit te Velipojes. Kengetare nga Shkodra dhe dyshja speciale e ftuar enkas per kete nate Devis Xherahu dhe Lefteris Pantazis kane elektrizuar pushuesit e stacionuar ne Velipoje, ku per me shume se 3 ore live, ato kane kenduar kenget me te perzgjedhura te repertorit shqiptar e te huaj. Nje nate magjike si vete investimi qe ka marre jete ne Velipoje nga kompania Xhenis, me te parin resort te permasave te tilla ne brigjet e Adriatikut, ne 4.4 Ha. E para qe hapi koncertin e kesaj nate ishte kengetarja shkodrane Mukades Çanga. Me pas ishin kengetaret Adnan Bala dhe Hajro Pepa. Ne kete nate nuk munguan as castet gazmore te sjella nga humoristi Anton Krosaj... atmosfera filloi te ndizej edhe me shume nga emrat qe pasuan ku fillimisht ishte kengetarja e re Megi Laska qe solli nje kolazh kengesh shqiptare e te huaja. Skena me pas i eshte dorezuar te ftuarve special Devis Xherahu e me pas Lefteris Pantazis qe me interpretimet solo dhe duet ndezen atmosferen e kesaj nate te magjishme te dhuruar nga kompania Xhenis. Velipoja "Grand Europa" Resort, i pari investim i ketij lloji ne keto 20 vite ne brigjet shqiptare, me standartet e fjales se fundit do te jete gati pas 2 vitesh e gjysem. Premtimi i drejtuesve te kompanise Xhenis ka qene i qarte, festa tjeter madheshtore dhe e paharruar do te jete ne inagurimin e perfundimit te punimeve ne kete kompleks gjigand.